



**Datë :30.03.2020**

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara nga Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 të datës 15.03.2020 **Për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik**, vendimin Nr 01/07 i datës 11.03.2020 ( i ndryshuar dhe plotësuar me Vendim Nr 01/16 i datës 26.03.2020 ,vendimin Nr 01/15 i datës 23.03.2020 ( i ndryshuar dhe plotësuar me vendim Nr. 02/17 i datës 27 mars 2020 ), Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik , nxjerrë këtë:

## **NJOFTIM**

**Për të gjitha Autoritetet Kontraktuese (AK) dhe Operatorët Ekonomik (OE) lidhur me tri dëshmitë e kërkuara nga fituesi në formë fizike si “Vërtetimi nga Gjykata”, “Vërtetimi i ATK-së” dhe “Sigurimi i Tenderit” në rast se një siguri e tillë është kërkuar në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në situatën e krijuar si rezultat i Corona Virusit COVIT – 19, KRPP sqaron si në vijim:**

- I. Neni 26.8 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP), përcakton:
  - *“Në raste kur lëshimi i dokumenteve ose certifikatave, nën **kërkesat e përshtatshmërisë ose përshtatjes profesionale** nuk janë të arritshme për arsye objektive, ose kur këto dokumente nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat evidenca duhet të prodhohet, një deklaratë e shkruar në betim nga OE mund të pranohet si evidencë e mjaftueshme. Pavarësisht nga neni 65 i LPP –së dhe Neni 66 i LPP-se”.*

Në përputhje me pikën e lart cituar të nenit 26.8 të RRUOPP, si dhe në përputhje me rrethanat e krijuara duke marrë në konsideratë **distancimet dhe/ose kufizimet sociale** si masë mbrojtëse kundër pandemisë së Corona-Virusit COVIT-19, dhe meqenëse në këto rrethana edhe Gjykatat e kanë kufizuar punën me palë dhe nëse është e pamundur të nxjerrët Vërtetimi nga Gjykata (dëshmi e kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në bazë të nenit 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së), të gjithë Operatorët Ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, si evidencë të mjaftueshme mund të dërgojnë në AK një **Deklaratë me shkrim nën Betim** përmes Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik duke i potencuar arsyet objektive për pamundësinë e sjelljes së dëshmisë në fjalë.

Kurdo që është e mundur, OE do të sjellë Vërtetimin nga Gjykata në formë fizike, pavarësisht se OE në fjalë është duke ekzekutuar kontratën që i është dhënë nga AK.

- II. “Vërtetimi i ATK-së” si dëshmi e kërkuar nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, nëse nuk mund të sigurohet në formë fizike për shkak të rrethanave të krijuara, OE mund të dorëzojë dokumentin të cilin mund ta shkarkojë nga sistemi elektronik i ATK-së e që dëshmon kërkesën e specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së.
- III. Në përputhje me nenin 57 të LPP-së, **Sigurimi i tenderit, nuk duhet domosdoshmërisht të kërkohet nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.** Pra, sipas këtij neni është në diskrecion të AK-së. Sidoqoftë, Opinioni i KRPP është që të mos kërkohet nga AK Sigurimi i Tenderit në rrethanat ekzistuese dhe derisa ato nuk pushojnë, me qëllim të shmangies së kontakteve me persona fizik. Megjithatë, nëse një siguri e tillë është kërkuar, ajo duhet të dorëzohet nga OE në përputhje me kërkesën e specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë sipas nenit 29.13 të RRUOPP.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik

